



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
OPERATORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
DREJTORIA E SPITALIT RAJONAL LEZHË**

Nr. ____ Prot.

Data: 26.08.2025

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - SHERBIME

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Mirembajtje Full Risk e pajisjeve mjekesore për Spitalin Rajonal Lezhe e ndare ne 19 lote” - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 2 vjeçar (24 muaj).

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV) :

Shërbime për riparime dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore – 50421000-2

VLERA E FONDIT LIMIT: 37,137,239.00 (tridhjetë e shtatë milion e njëqind e tridhjetë e shtatë mijë e dyqind e tridhjetë e nëntë) lekë pa TVSH i konvertuar në euro sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë datë 25/08/2025: 381,952.47 (treqind e tetëdhjetë e një mijë nentëqind e pesëdhjetë e dy pikë 47) Euro pa TVSH e ndarë në lote si më poshtë:

Nr.	Emertimi I loteve	Fondi limit në Lekë	Fondi limit ne Euro
1	Loti 1: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit PHILIPS ose ekuivalentin e saj	13,776,000.00	141,684.67
2	Loti 2: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit DMS ose ekuivalentin e saj	648,000.00	6,664.61
3	Loti 3: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit NOVA MEDTEK ose ekuivalentin e saj	1,800,000.00	18,512.80
4	Loti 4: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit GIOTTO ose ekuivalentin e saj	1,778,400.00	18,290.65
5	Loti 5: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit JPI HEALTHCARE ose ekuivalentin e saj	1,598,700.00	16,442.46

6	Loti 6: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit KARL STORZ ose ekuivalentin e saj	2,847,000.00	29,281.09
7	Loti 7: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit NSPITALose ekuivalentin e saj	682,500.00	7,019.44
8	Loti 8: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit EDAN ose ekuivalentin e saj	1,496,752.00	15,393.93
9	Loti 9: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit KANMED ose ekuivalentin e saj	230,550.00	2,371.18
10	Loti 10: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit OLYMPUS ose ekuivalentin e saj	2,996,355.00	30,817.19
11	Loti 11: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit NOVOS ose ekuivalentin e saj	644,160.00	6,625.12
12	Loti 12: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit KLS Martin ose ekuivalentin e saj	626,556.00	6,444.06
13	Loti 13: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit KONTEC ose ekuivalentin e saj	189,093.00	1,944.80
14	Loti 14: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit AXION ose ekuivalentin e saj	456,200.00	4,691.97
15	Loti 15: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit ZOLL ose ekuivalentin e saj	1,722,258.00	17,713.24
16	Loti 16: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit J&J ose ekuivalentin e saj	346,916.00	3,567.99
17	Loti 17: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit GIMA ose ekuivalentin e saj	447,733.00	4,604.89
18	Loti 18: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit MIDMARK ose ekuivalentin e saj	251,066.00	2,582.19
19	Loti 19: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit GE ose ekuivalentin e saj	4,599,000.00	47,300.22

Lloji i procedurës së prokurimit është: **E HAPUR MBI KUFIRIN E LARTË MONETAR - prokurim me mjete elektronike – sherbime.**

Lloji i procedurës është përzgjedhur në zbatim të nenit 42, pika 2, të të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe VKM nr. 285 ,datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 47.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria e Spitalit Rajonal Lezhe** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT (TË NJEJTA PËR TË GJITHA LOTET)

1.Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 82 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe VKM-ja Nr.285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik “, i ndryshuar , neni 26, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 82: Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.

Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

b. Sigurimi i ofertës, sipas shtojcës 3;

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës ne total për të gjitha lotët është : **742,744.78 (shtatëqind e dyzetë e dy mijë e shtatëqind e dyzetë e katër pike 78) lekë, i konvertuar në euro sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë datë 25/08/2025: 7,639.05 (shtate mije e gjashtëqind e tridhjetë e nente pike 05) Euro.**

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

Nr.	Emertimi i loteve	Sigurimi i ofertes	Sigurimi i ofertes ne Euro
1	Loti 1: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit PHILIPS ose ekuivalentin e saj	275,520.00	2,833.69
2	Loti 2: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit DMS ose ekuivalentin e saj	12,960.00	133.29

3	Loti 3: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit NOVA MEDTEK ose ekuivalentin e saj	36,000.00	370.26
4	Loti 4: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit GIOTTO ose ekuivalentin e saj	35,568.00	365.81
5	Loti 5: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit JPI HEALTHCARE ose ekuivalentin e saj	31,974.00	328.85
6	Loti 6: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit KARL STORZ ose ekuivalentin e saj	56,940.00	585.62
7	Loti 7: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit INSPITAL ose ekuivalentin e saj	13,650.00	140.39
8	Loti 8: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit EDAN ose ekuivalentin e saj	29,935.04	307.88
9	Loti 9: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit KANMED ose ekuivalentin e saj	4,611.00	47.42
10	Loti 10: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit OLYMPUS ose ekuivalentin e saj	59,927.10	616.34
11	Loti 11: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit NOVOS ose ekuivalentin e saj	12,883.20	132.50
12	Loti 12: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit KLS Martin ose ekuivalentin e saj	12,531.12	128.88
13	Loti 13: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit KONTEC ose ekuivalentin e saj	3,781.86	38.90
14	Loti 14: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit AXION ose ekuivalentin e saj	9,124.00	93.84
15	Loti 15: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit ZOLL ose ekuivalentin e saj	34,445.16	354.26
16	Loti 16: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit J&J ose ekuivalentin e saj	6,938.32	71.36
17	Loti 17: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit GIMA ose ekuivalentin e saj	8,954.66	92.10
18	Loti 18: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit MIDMARK ose ekuivalentin e saj	5,021.32	51.64
19	Loti 19: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit GE ose ekuivalentin e saj	91,980.00	946.00

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ,ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2. Ofertuesi duhet të paraqesë: (TË NJEJTA PËR TË GJITHA LOTET)

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kriteri 2.1.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

a) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë *Certifikatën ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”*, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. **Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave.**

b) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë *Certifikatën ISO 13485:2016 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”*, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. **Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave.**

c) OE duhet të jetë i autorizuar nga MSHMS për tregëtim të pajisjeve mjekësore

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën gjejmë të përcaktuar se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorisë së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, datë 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, datë 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar: **(TË NJEJTA PËR TË GJITHA LOTET)**

2.2.1. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore për tre vitet e fundit nuk do të jete me e vogel se:
37,137,239.00 (tridhjetë e shtatë milion e njëqind e tridhjetë e shtatë mijë e dyqind e tridhjetë e nëntë) lekë, konvertuar në euro sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë datë 25/08/2025:
381,952.47 (treqind e tetëdhjetë e një mijë nentëqind e pesëdhjetë e dy pikë 47) Euro.

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e xhiros vjetore për secilin Lot nuk duhet të jetë me e vogel se:

Nr.	Emertimi i loteve	Xhiros vjetore për tre vitet e fundit në Lekë	Xhiros vjetore për tre vitet e fundit në Euro
1	Loti 1: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit PHILIPS ose ekuivalentin e saj	13,776,000.00	141,684.67
2	Loti 2: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit DMS ose ekuivalentin e saj	648,000.00	6,664.61
3	Loti 3: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit NOVA MEDTEK ose ekuivalentin e saj	1,800,000.00	18,512.80
4	Loti 4: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit GIOTTO ose ekuivalentin e saj	1,778,400.00	18,290.65
5	Loti 5: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit JPI HEALTHCARE ose ekuivalentin e saj	1,598,700.00	16,442.46
6	Loti 6: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit KARL STORZ ose ekuivalentin e saj	2,847,000.00	29,281.09
7	Loti 7: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit INSPITAL ose ekuivalentin e saj	682,500.00	7,019.44
8	Loti 8: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit EDAN ose ekuivalentin e saj	1,496,752.00	15,393.93
9	Loti 9: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit KANMED ose ekuivalentin e saj	230,550.00	2,371.18
10	Loti 10: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit OLYMPUS ose ekuivalentin e saj	2,996,355.00	30,817.19
11	Loti 11: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit NOVOS ose ekuivalentin e saj	644,160.00	6,625.12
12	Loti 12: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit KLS Martin ose ekuivalentin e saj	626,556.00	6,444.06
13	Loti 13: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit KONTEC ose ekuivalentin e saj	189,093.00	1,944.80
14	Loti 14: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit AXION ose ekuivalentin e saj	456,200.00	4,691.97
15	Loti 15: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit ZOLL ose ekuivalentin e saj	1,722,258.00	17,713.24
16	Loti 16: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit J&J ose ekuivalentin e saj	346,916.00	3,567.99
17	Loti 17: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit GIMA ose ekuivalentin e saj	447,733.00	4,604.89

18	Loti 18: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit MIDMARK ose ekuivalentin e saj	251,066.00	2,582.19
19	Loti 19: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit GE ose ekuivalentin e saj	4,599,000.00	47,300.22

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar: në nenin 43 pika 2/a dhe pika 4, 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet:

Neni 43 pika 2/a

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

4. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

2.3 Kapaciteti teknik **(TË NJEJTA PËR TË GJITHA LOTET)**

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

Kriteri 2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më e vogël se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Vlera për shërbimet e mëparshme të ngjashme për të gjitha lotët , të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës , nuk do të jetë me e vogël se: 7,427,447.80 (shtatë milion e katërqind e njëzetë e shtatë mijë e katërqind e dyzetë e shtatë pikë 80) lekë, konvertuar në euro sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë datë 25/08/2025: 76,390.49 (shtatedhjetë e gjashtë mijë e treqind e nentëdhjetë pike 49) Euro.

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e kontratave për shërbimet e mëparshme për secilin Lot nuk duhet të jetë me e vogël se:

Nr.	Emertimi i loteve	Vlera e shërbimeve të mëparshme në Lekë	Vlera e shërbimeve të mëparshme në Euro
1	Loti 1: Mirembajtja e aparaturave mjekesore të prodhuesit PHILIPS ose ekuivalentin e saj	2,755,200.00	28,336.93
2	Loti 2: Mirembajtja e aparaturave mjekesore të prodhuesit DMS ose ekuivalentin e saj	129,600.00	1,332.92
3	Loti 3: Mirembajtja e aparaturave mjekesore të prodhuesit NOVA MEDTEK ose ekuivalentin e saj	360,000.00	3,702.56
4	Loti 4: Mirembajtja e aparaturave mjekesore të prodhuesit GIOTTO ose ekuivalentin e saj	355,680.00	3,658.13
5	Loti 5: Mirembajtja e aparaturave mjekesore të prodhuesit JPI HEALTHCARE ose ekuivalentin e saj	319,740.00	3,288.49
6	Loti 6: Mirembajtja e aparaturave mjekesore të prodhuesit KARL STORZ ose ekuivalentin e saj	569,400.00	5,856.22
7	Loti 7: Mirembajtja e aparaturave mjekesore të prodhuesit INSPITAL ose ekuivalentin e saj	136,500.00	1,403.89
8	Loti 8: Mirembajtja e aparaturave mjekesore të prodhuesit EDAN ose ekuivalentin e saj	299,350.40	3,078.79
9	Loti 9: Mirembajtja e aparaturave mjekesore të prodhuesit KANMED ose ekuivalentin e saj	46,110.00	474.24
10	Loti 10: Mirembajtja e aparaturave mjekesore të prodhuesit OLYMPUS ose ekuivalentin e saj	599,271.00	6,163.44
11	Loti 11: Mirembajtja e aparaturave mjekesore të prodhuesit NOVOS ose ekuivalentin e saj	128,832.00	1,325.02
12	Loti 12: Mirembajtja e aparaturave mjekesore të prodhuesit KLS Martin ose ekuivalentin e saj	125,311.20	1,288.81
13	Loti 13: Mirembajtja e aparaturave mjekesore të prodhuesit KONTEC ose ekuivalentin e saj	37,818.60	388.96
14	Loti 14: Mirembajtja e aparaturave mjekesore të prodhuesit AXION ose ekuivalentin e saj	91,240.00	938.39

15	Loti 15: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit ZOLL ose ekuivalentin e saj	344,451.60	3,542.65
16	Loti 16: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit J&J ose ekuivalentin e saj	69,383.20	713.60
17	Loti 17: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit GIMA ose ekuivalentin e saj	89,546.60	920.98
18	Loti 18: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit MIDMARK ose ekuivalentin e saj	50,213.20	516.44
19	Loti 19: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit GE ose ekuivalentin e saj	919,800.00	9,460.04

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën **jo më të vogël se 40%** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë dhe është në përputhje me përcaktimet e VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, neni 41 pika 3:

3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar (jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës).

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entitet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Kriteri 2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë që ka të paktën 2 (dy)* **Inxhinierë/Specialistë** në stafin e vet të trajnuar për pajisjet mjekësore të cilët do të kryejnë shërbimin e mirëmbajtjes dhe furnizim vendosjes së pjesëve të këmbimit, të vërtetuar nëpërmjet: diplomës, çertifikatës së trajnimit, CV-së, kontratës individuale të punës. Vetëm ky staf do të kryejë ndërhyrjet e mirëmbajtjes parandaluese, korrigjuese dhe kalibruese të pajisjeve mjekësore.

***Shënim:** Me këtë numër minimal të kërkuar synohet të garantohet gjatë gjithë kohës ofrimi i shërbimit dhe parandalohen rastet e pamundësisë së prezencës së stafit për arsye të ndryshme objektive (leje vjetore, raport mjekësor, trajnime etj).

***Shënim:** Ky kriter në fazën e ofertimit të operatorëve ekonomik do të konsiderohet i permbushur me dorezimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Në rastet kur OE do të shpallet fitues duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me pikën 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në nenin 41, të VKM 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohen të gjitha kriteret e mundshme që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese. Për këtë procedurë objekti i prokurimit është: Mirëmbajtje e pajisjeve mjekësore të prodhuesit Philips/ ose ekuivalent, prodhuesit GE/ose ekuivalent, prodhuesit Karl Shtorz/ose ekuivalent, Etj., për 24 muaj, ndarë në lote (gjithsej 19). Ky kriter konkretisht, është vendosur në mënyrë që të gjithë procedura të bëhet nga persona të kualifikuar të cilët garantojnë zbatimin e kontratës plotësisht dhe në mënyrën e duhur, gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj. Ky kriter është miratuar dhe vendosur nga anetarët e Njesisë së Prokurimit që kanë specialitetin përkatës në lidhje me Kërkesat për kualifikim, në përputhje me Nenin 77 pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. Ky kriter mbështetet edhe në Rekomandimin e APP Nr. 8197, datë 03.09.2018 Prot “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit mallra, punë, shërbime”. Ky kriter gjendet mbështetje në VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të nenit 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, pikën 4, ku përcaktohet se: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **a)** licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose, **b)** një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose, **c)** fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose, **ç)** mjetet dhe

pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Kriteri 2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqes **Autorizim nga prodhuesi / MAH / ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin)**, për të garantuar mirëmbajtjen cilësore, të sigurtë dhe pjesë origjinale të pajisjeve mjekësore objekt në këtë procedurë prokurimi. Autorizimi duhet të jete original dhe nese nuk eshte ne gjuhen angleze ose shqipe, të përkthehet dhe të noterizohet, si dhe të jetë i vlefshëm në momentin e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me pikat 2 dhe 4 të nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku është e cituar: 5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojnë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Autorizimi për OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributori i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t'u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, garanton mirëmbajtjen cilësore, të sigurtë dhe pjesë origjinale të pajisjeve mjekësore objekt në këtë procedurë prokurimi. Si dhe gjithashtu ky kriter u vendos në mbështetje të **Rekomandimit nr. 3341/1 prot. Datë 20.03.2018 të Agjensisë së Prokurimit Publik** (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore **”Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentet e tenderit të procedurave të prokurimit publik”**.

Kriteri 2.3.4 OE duhet të paraqesë **Autodeklarate që merr përsipër furnizimi/zevendesimin me pjesë këmbimi dhe aksesore dhe se:**

- Materialet dhe pjesët e këmbimit duhet të jenë të reja, origjinale ose nga prodhues të tjerë të certifikuar, dhe gjithmonë në përputhje me ato të përdorura fillimisht në pajisje, duke siguruar konformitet me udhëzimet e dhëna nga prodhuesi në dokumentacionin teknik furnizuar me pajisjen.
- Të jenë të certikuara me CE ose FDA sipas standarteve dhe direktivave të aprovuara në tregun Europian.
- Kur është e aplikueshme, pjesët e këmbimit dhe aksesorët duhet të kenë manual instalimi shoqërues sipas rekomandimeve të prodhuesit. Një kopje e këtij manuali i dorëzohet përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor.
- Pjesët duhet të kenë jo më pak se 1 (një)* vit garanci ku të përfshihen të gjitha defektet e mundshme të tyre. (Sqarim: Afati i garancisë së pjesëve të këmbimit mund të tejkalojë afatin e kësaj kontrate. I kontraktuari detyrohet të mirëmbajë, sipas kushteve të garancisë,

pjesën e këmbimit edhe pas afatit të përfundimit të kësaj kontrate nëse defekti i pjesës ndodh brenda afatit një vjeçar të garancisë së pjesës së këmbimit.)

Kriteri 2.3.5 OE duhet të paraqesë **Autodeklarate ku deklarohet se do të bëjë inspektimin e sigurisë së pajisjeve mjekësore, të paktën** një inspektim sigurie sipas standartit ndërkombëtar elektrik IEC 62353 të specifikuar nga Direktiva e Pajisjeve Mjekësore MDD (ose MDR) 98/79 EC (të përditësuar), ose EU 2016/425 (të përditësuar) ose FDA ose (EU) 2017/745, kur është e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Keshillit të Europës, për çdo pajisje mjekësore dhe pjesëve përbërëse të saj gjatë periudhës së kësaj kontrate, nëpërmjet stafit të trajnuar dhe certifikuar, kur kjo është e zbatueshme. Inspektimi përfshin:

- a. Operatori Ekonomik duhet të kryejë inspektim vizual, testime dhe matje me aparaturë të kalibruara.
- b. Operatori Ekonomik duhet të planifikojë kryerjen e këtyre testimeve në bashkëpunim me stafin e Sektorit të Inxhinierisë Klinike bazuar në specifikimet e prodhuesit.
- c. Në përfundim të çdo inspektimi sigurie duhet të përpilohet një raport përshkruar dhe firmoset nga specialistët e Sektorit të Inxhinierisë Klinike dhe Inxhinieri/Tekniku i kompanisë (OE) që kryen testin.
- d. Pas çdo testimi sigurie në pajisje duhet vendosur një shenjë treguese e gjendjes së sigurisë së pajisjes.
- e. Përveç rasteve të sipërpërmendura, shërbimi i inspektimit e verifikimit të sigurisë duhet të kryhet edhe pas mirëmbajtjes korrigjuese, kur është e zbatueshme.
- f. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kërkojë verifikime përveç atyre të planifikuara, në raste të veçanta, në kushte apo sipas nevojave të veçanta dhe Kontraktuesi është i detyruar të pranojë këto kërkesa pa kushte.

Argumentimi: Kriteret e vendosura në DST në pikat, 2.3.4, dhe 2.3.5 janë vendosur në përputhje me nenin 38, nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, "Për Prokurimin Publik", në nenin 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, datë 20.03.2018 "Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentat e tenderit të procedurave të prokurimit publik", rekomandimin e APP dhe Drejtorise së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, datë 20.03.2018 dhe nr.145 prot, datë 16.03.2018 "Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilesisë", Autodeklarate nga ofertuesi që merr përsipër zëvendësimin e pjesëve të këmbimit dhe konsumit, që ato do jenë të reja dhe origjinale dhe në përputhje me ato të përdorura fillimisht (të garantuara nëpërmjet certifikimit CE ose FDA) është një dokument i domosdoshëm për t'u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që do të kryeje shërbimin e mirëmbajtje/riparimit, jep garancinë e riparimit të këtyre pajisjeve, në rastet e nevojshme, sipas kërkesave të percaktuara në dokumentat e tenderit. Theksojmë se pajisjet mjekësore janë shumë specifike dhe riparimi i tyre kërkon pjesë specifike origjinale të vete pajisjes, për një funksionim të plotë, të certifikuar me CE për të garantuar cilësinë e tyre të plotë.

Kriteri 2.3.6 OE duhet të paraqesë Autodeklarate ku garanton se në rast të shpalljes fituese, do të kryejë **shërbimin e mirëmbajtjes**, riparimin dhe zëvendësimin e çdo defekti/pjesë të mundshme/gjatë periudhës së kontratës, për pajisjen dhe të gjithë aksesoret **të cilat janë të**

lidhura me pajisjen, në mënyrë që ajo të jetë në shërbim të stafit dhe të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin e pajisjes brenda standarteve të përcaktuara nga prodhuesi.

Kriteri 2.3.7 Ofertuesi (Operatori Ekonomik) duhet të lëshojë një Deklaratë me anë të së cilës **merr përsipër sigurimin teknik të stafit të tij** gjatë kohës së punës në ambientet e SRL, dhe kjo e fundit nuk mban asnjë përgjegjësi për aksidentet e ndodhura punonjësve të Operatorit Ekonomik në ambientet e saj.

Kriteri 2.3.8 OE duhet të paraqesë **Autodeklarate** me anë të së cilës **të përcaktojë më shumë se një person kontakti për raportimin e defekteve** dhe çështjeve administrative, për të cilët duhet të bëjë me dije Autoritetin Kontraktor (telefon dhe email). Çdo ndryshim kontakti duhet të raportohet menjëherë me shkrim palëve. Stafi (i të Kontraktuarit) duhet të jetë i pajisur me kartë (mjet) identifikimi personal gjatë vizitave në ambientet e Kontraktuesit dhe të shoqërohet nga stafi i Sektorit të Inxhinierisë Klinike.

Argumentimi: Kriteret e vendosura në DST në pikat 2.3.6, 2.3.7, dhe 2.3.8, janë vendosur nga anetaret e NJP që kanë specialitet përkatës në lidhje me kriteret teknike si dhe është në përputhje me nenin 38, nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, në nenin 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, datë 20.03.2018 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentat e tenderit të procedurave të prokurimit publik”, rekomandimin e APP .

Kriteri 2.3.9 OE duhet të paraqesë planin e veprimeve të mirëmbajtjes parandaluese që ofertuesi do të ndërmarrë, për secilin grup pajisjesh, ku të përcaktohen periodiciteti, procedurat operative dhe protokollat që do të përdorë përfshirë kalibrimet dhe testimet periodike të sigurisë elektrike dhe mekanike të pajisjeve në përputhje me standartet përkatëse europiane.

Argumentimi: Bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 2 të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku ndër të tjera përcaktohet se kjo kërkesë i shërbejnë autoritetit kontraktor për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale.

Shënim për operatorët ekonomik:

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit të pikës 6 në nenin 82, VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”,*

“d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.”

Gjithashtu risjellim ne vemendje se:

- Autoriteti/enti kontraktor perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit permbushes per keto pika do te jete kusht skualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor mund te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht skualifikimi.
- Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Ky kriter u vendos ne perputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne nenit 41, të VKM 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohen të gjitha kriteret e mundshme që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese. Për këtë procedure objekti i prokurimit eshte: Mirëmbajtje e pajisjeve të prodhuesve të ndryshem/ ose ekuivalentet e tyre,” për 24 muaj”, ndarë në lote (gjithsej 19). Ky kriter konkretisht, është vendosur në mënyrë që e gjithë procedura të bëhet nga persona të kualifikuar të cilët garantojnë zbatimin e kontratës plotësisht dhe në mënyrën e duhur, gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj. *Ky kriter eshte miratuar dhe vendosur nga anetaret e Njesise se Prokurimit qe kane specialitetin perkates ne lidhje me Kërkesat për kualifikim, në përputhje me Nenin 77 pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”,.Ky kriter mbeshtetet edhe ne Rekomandimin e APP Nr. 8197, date 03.09.2018 Prot “Mbi hartimin e kriterëve per kualifikim per procedurat e prokurimit mallra, pune, shërbime”.Ky kriter gjen mbeshtetje ne VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” te nenit 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, piken 4, ku percaktohet se: *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a)licenca**

profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose, **b**)një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose, **c**)fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose, **ç**)mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

SPECIFIKIMET TEKNIKE DHE TERMAT E REFERENCËS:

(TË NJEJTA PËR TË GJITHA LOTET)

Specifikimet Teknike të Përgjithshme

1. Operatori ekonomik duhet të ketë më shumë se një numër kontakti për raportimin e defekteve dhe çështjeve administrative, për të cilët duhet të bëjë me dije Autoritetin Kontraktor (telefon dhe/ose e-mail).
2. Çdo ndryshim kontakti duhet të raportohet menjëherë me shkrim palëve.
3. Stafi (i të kontraktuarit) duhet të jetë i pajisur me kartë (mjet) identifikimi personal gjatë vizitave në ambientet e Kontraktuesit dhe të shoqërohet nga stafi i Sektorit të Inxhinierisë Klinike.
4. Stafi teknik i operatorit ekonomik që do të punojë në Spitalin Rajonal Lezhe për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes duhet të jetë i siguar pasi kjo e fundit Spitali Rajonal Lezhe nuk mban asnjë përgjegjësi për aksidentet e ndodhura punonjësve të operatorit ekonomik në ambientet e saj.

Mirëmbajtja parandaluese/preventive e pajisjeve mjekësore

1. Mirëmbajtja parandaluese/preventive e pajisjeve mjekësore duhet të kryhet në përputhje me rekomandimet e prodhuesit përkatës për të parandaluar defektet që lidhen me përdorimin e tyre dhe pjesëve përbërëse, për të ruajtur pajisjet në gjendjen e duhur të funksionimit, për të siguruar cilësinë dhe besueshmërinë e rezultateve, për të evidentuar gjendje të tilla si vjetërsimi apo përkeqësimi i performancës.
2. Shërbimi për ndërhyrjet e mirëmbajtjes parandaluese, korrigjuese dhe kalibruese të pajisjeve mjekësore duhet të kryhet nga 2 (dy) Inxhinierë/Specialistë të certifikuar dhe të trajnuar për pajisjet mjekësore objekt prokurimi.

3. Operatori Ekonomik (Ofertuesi) duhet të paraqesë Rekomandimet nga prodhuesi i pajisjes/ve dhe një plan veprimesh të mirëmbajtjes parandaluese që përcakton periodicitetin, procedurat operative dhe protokollet që synon të përdorë, përfshirë kalibrimet.

Mirëmbajtja korrigjuese e pajisjeve mjekësore

1. Ndërhyrjet e mirëmbajtjes korrigjuese konsistojnë në përcaktimin e pranisë së një defekti ose mosfunksionimi, në identifikimin e shkaqeve, eliminimin e tyre dhe rivendosjen e karakteristikave origjinale, për garantimin e integritetit të pajisjes, të funksionimit dhe sigurisë së saj.
2. Shoqëria e kontraktuar (OE) duhet të kryejë shërbimin e mirëmbajtjes, riparimin dhe zëvendësimin e çdo defekti/pjese të mundshëm/e gjatë periudhës së kontratës, për pajisjen dhe të gjithë aksesorëve të cilat janë të lidhura me të, në mënyrë që ajo të jetë në shërbim të stafit mjekësor si: Tuba X-ray, Dedektorë, Kompjutera, Hard Drive, DVD-CD, Keyboard, Monitor, RAM, UPS, Bllok ushqimi, printer, infrastrukture rrjeti, fisha, sonda, mansheta, sensorë, elektroda, Ingranazhe, pjesë elektronike, elektrike, mekanike, hidraulike, valvula, pjesë mekanike, rrota, pistona, motorrë etj, që ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin e pajisjes brenda standarteve të përcaktuara nga prodhuesi përkatës.
3. Shoqëria e kontraktuar (OE) duhet të paraqitet për të kontrolluar/verifikuar/konstatuar problematikën brenda 24 (njetzet e kater) orëve nga marrja e njoftimeve (me e-mail dhe/ose telefon te të dhënat e kontaktit të paraqitur) nga Autoriteti Kontraktor për mosfunksionimin normal, probleme të ndryshme, konfigurime, sinjalizime apo defekte të pajisjes.
4. Në rastin kur nuk nevojiten pjesë këmbimi, korrigjimi i defektit duhet të realizohet jo më vonë se 48 orë pas konstatimit.
5. Në rast se konstatohet se për korrigjimin e një defekti nevojiten pjesë këmbimi, OE duhet të furnizojë dhe të vendosë pjesët e këmbimit, të riparojë defektin dhe të vendosë pajisjen në gjendje normale pune brenda 7 ditëve kalendarike.
6. Pas riparimeve apo ndërhyrjeve të kryera, zëvendësimi pjesësh këmbimi apo aksesorësh, shoqëria e kontraktuar (OE) duhet të kryejë kalibrimet e nevojshme, verifikimin e parametrave sikurse e rekomandon prodhuesi, për garantimin e funksionimit normal të pajisjes.
7. Shoqëria e kontraktuar do mundësojë të paktën një herë për secilën pajisje të grupit të pajisjeve lëvizjen, spostimin, çmontimin dhe rimontimin nëse kjo kërkohet nga Autoriteti Kontraktor.
8. Lëvizja, spostimi, çmontimi dhe rimontimi i pjesëve të pajisjes gjatë mirëmbajtjes korrigjuese është në ngarkim dhe përgjegjësi të të Kontraktuarit.

Furnizimi me pjesë këmbimi dhe aksesorë

1. Materialet dhe pjesët e këmbimit duhet të jenë të reja, origjinale ose nga prodhues të tjerë të certifikuar, dhe gjithmonë në përputhje me ato të përdorura fillimisht në pajisje, duke siguruar

konformitet me udhëzimet e dhëna nga prodhuesi në dokumentacionin teknik furnizuar me pajisjen.

2. Të jenë të certifikuara me CE sipas standardeve dhe direktivave të aprovuara në tregun European.
3. Kur është e aplikueshme, pjesët e këmbimit dhe aksesoret duhet të kenë manual instalimi shoqërues sipas rekomandimeve të prodhuesit. Një kopje e këtij manuali i dorëzohet përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor.
4. Pjesët duhet të kenë jo më pak se 1 (një)* vit garanci nga rikthimi në gjendje të plotë funksionale të pajisjes, ku të përfshihen të gjitha defektet e mundshme të tyre.

*(*Sqarim: Afati i garancisë së pjesëve të këmbimit mund të tejkalojë afatin e kontratës/marrëveshjes së lidhur. I kontraktuari detyrohet të mirëmbajë, sipas kushteve të garancisë, pjesën e këmbimit edhe pas afatit të përfundimit të kësaj kontrate nëse defekti i pjesës ndodh brenda afatit një vjeçar të garancisë së pjesës së këmbimit/ ose arrijen e maksimumit të konsumit të vërtetuar nga prodhuesi.)*

Inspektimi i sigurisë së pajisjeve mjekësore

1. Operatori Ekonomik duhet të kryejë të paktën 1(një) inspektim sigurie sipas standardit ndërkombëtar elektrik IEC 62353 të specifikuar nga Direktiva e Pajisjeve Mjekësore MDD (ose MDR) 98/79 EC (të përditësuar), ose EU 2016/425 (të përditësuar) ose FDA ose (EU) 2017/745 dhe azhurnimet përkatëse, sipas aplikueshmërisë dhe Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Evropës, për çdo pajisje mjekësore dhe pjesëve përbërëse të saj gjatë periudhës së kësaj kontrate, nëpërmjet stafit të trajnuar dhe certifikuar, sipas nevojave të AK.
2. Operatori Ekonomik duhet të kryejë inspektim vizual, testime dhe matje me aparatura të kalibruara, në bashkëpunim me stafin e AK bazuar në specifikimet e prodhuesit.
3. Në përfundim të çdo inspektimi sigurie duhet të përpilohet një raport përshkrues dhe firmoset nga specialistët e AK dhe Inxhinieri/Specialisti i kompanisë (OE) që kryen testin.
4. Pas çdo testimi sigurie në pajisje duhet vendosur një shenjë treguese (të standardizuar nga AK) e gjendjes së sigurisë së pajisjes.
5. Përveç rasteve të sipërpërmendura, shërbimi i inspektimit e verifikimit të sigurisë duhet të kryhet edhe pas mirëmbajtjes korrigjuese, kur është e zbatueshme.
6. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kërkojë verifikime përveç atyre të planifikuara, në raste të veçanta, në kushte apo sipas nevojave të veçanta dhe Kontraktuesi është i detyruar të pranojë këto kërkesa pa kushte.

Loti 1: Mirembajtja e aparaturave mjekësore të prodhuesit PHILIPS ose ekuivalentin e saj

Nr	Emri i pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Viti prodhimit
----	-----------------	-----------	--------	----------------

1	CT skaner	Philips	MX 16	2010
---	-----------	---------	-------	------

Loti 2: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit DMS ose ekuivalentin e saj

Nr	Emri i pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Viti prodhimit
1	Densimetri	DMS	stratos DR	2022

Loti 3: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit NOVA MEDTEK ose ekuivalentin e saj

Nr	Emri i pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Viti prodhimit
1	Sistem kirurgjikal me nje krah C- ARM pa perfshire dedektori	NOVA MEDTEK	novarex NT-20	2021

Loti 4: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit GIOTTO ose ekuivalentin e saj

Nr	Emri i pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Viti I prodhimit
1	MAMOGRAFI DIGJITALE	GIOTTO	IMAGE: 3IDL	2019

Loti 5: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit JPI HEALTHCARE ose ekuivalentin e saj

Nr	Emri pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Viti I prodhimit
1	GRAFI STACIONARE DIGJITALE	JPI HEALTHCARE	DR 150	2019

Loti 6: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit KARL STORZ ose ekuivalentin e saj

Nr	Emri pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Viti I prodhimit
1	PAJISJE LAPAROSKOPIE	KARL STORZ	SET	2020
2	SISTEM HISTERESKOPIE	KARL STORZ	SET	2020

Loti 7: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit INSPITAL ose ekuivalentin e saj

Nr	Emri i pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Viti prodhimit
1	Elektrobisturi mono&bipolare	INSPITAL	NS02.50	2020
2	Krevat operacioni gjinekologjik	INSPITAL	OT80.20S	2021

Loti 8: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit EDAN ose ekuivalentin e saj

Nr	Emri pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Viti I prodhimit
1	MONITOR PACIENTI	EDAN	IM8	2021
2	MONITOR PACIENTI	EDAN	IM8	2016
3	ECG	EDAN	SE- 12 ekspres	2021
4	ECG	EDAN	SE- 12 ekspres	2016
5	ECG	EDAN	SE - 3	2007
6	KOLPOSKOP	EDAN	C3A	2021
7	EKO PORTABEL	EDAN	U-50	2016

Loti 9: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit KANMED ose ekuivalentin e saj

Nr	Emri pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Viti I prodhimit
1	KREVAT NGROHES	KANMED	BË3	2021

Loti 10: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit OLYMPUS ose ekuivalentin e saj

Nr	Emri pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Viti I prodhimit
1	Gastrokolono skopi	OLYMPUS	GIF- Q165	2021

Loti 11: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit NOVOS ose ekuivalentin e saj

Nr	Emri pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Viti I prodhimit
-----------	----------------------	------------------	---------------	-------------------------

1	INKUBATOR	Novos	KL-1000	2020
2	Njesi reanimimi (Radiant)	Novos	KR -1000	2020
3	PAJISJE FOTOTERAPIE	Novos	Bililed Maxi	2020

Loti 12: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit KLS Martin ose ekuivalentin e saj

Nr	Emri pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Viti I prodhimit
1	LLAMPE OPERATORE	KLS Martin	MARLed E9i	2020

Loti 13: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit KONTEC ose ekuivalentin e saj

Nr	Emri pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Viti I prodhimit
1	Monitor I RZF se bebit	Kontec	CMS800G	2021

Loti 14: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit AXION ose ekuivalentin e saj

Nr	Emri pajisjes	Prodhuesi	modeli	Viti I prodhimit
1	DEFIBRILATOR	AXION	DKI-N-11	2021
2	DYSHEK FOTOTERAPIE	AXION	OFTN -03	2021

Loti 15: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit ZOLL ose ekuivalentin e saj

Nr	Emri pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Viti I prodhimit
1	DEFIBRILATOR	ZOLL	R series ALS	2005
2	RESPIRATOR PORTABEL	ZOLL	731 series	

Loti 16: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit J&J ose ekuivalentin e saj

Nr	Emri i pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Viti I prodhimit
1	ELEKTROBISTURI E AVANCUAR	J&J	GEN11	2021

Loti 17: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit GIMA ose ekuivalentin e saj

Nr	Emri pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Viti I prodhimit
1	INHALATOR	GIMA	CORSIA	2018
2	MAGNETO TERAPI	GIMA	MT PROFESSIONAL	2015
3	AEROSTERIL	GIMA	DT 80	2005
4	ASPIRATOR	GIMA	TOBI HOSP	

Loti 18: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit MIDMARK ose ekuivalentin e saj

Nr	Emri pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Viti I prodhimit
1	AUTOKLLAVE	MIDMARK	B23	2021

Loti 19: Mirembajtja e aparaturave mjekesore te prodhuesit GE ose ekuivalentin e saj

Nr	Emri pajisjes	Prodhuesi	Modeli	Viti I prodhimit
1	VENTILATOR/RESPIRATOR	GE	Carescape R 860	2019
2	EKO ABDOMINALE	GE	Versana Premier	2020
3	EKO ABDOMINALE	GE	Versana aktive	2020
4	APARAT NARKOZE	GE	9100c NXT	2018
5	EKO ABDOMINALE OBSETER	GE	logic F8	2018
6	EKO ABDOMINALE OBSETER	GE	Versana Aktive	2021

7	EKO ABDOMINALE OBSETER	GE	Versana Premier	2021
---	---------------------------	----	-----------------	------

Argumentimi: Keto specifikime teknike u vendosen ne mbeshtetje te Shkreses nr.918 prot..., datë 06.08.2025 “Kërkesë” të Sektorit Teknik, si dhe shkresën nr. 979/2 Prot..., datë 21.08.2025, “Proces-verbal mbi hartimin e kërkesave te vecanta per kualifikim” të specialistit të fushës, perlllogaritjen fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt: **“Mirembajtje Full Risk e pajisjeve mjekesore për Spitalin Rajonal Lezhe e ndare ne 19 lote” - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 2 vjeçar (24 muaj)**, si dhe ne perputhje me nenin 4, pika 36 të Ligjin nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenin 41, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Afatet e ekzekutimit:

Kohëzgjatja e kontratës: 24 muaj nga lidhja e Marrëveshjes Kuadër

Kontratat do të jepen brenda periudhës, nga momenti i lidhjes së MK me OE fitues për çdo lot, me afat përfundimtar, 24 muaj nga lidhja e MK.

Shtojca 8

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

(TË NJEJTA PËR TË GJITHA LOTET)

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: “Mirembajtje Full Risk e pajisjeve mjekesore për Spitalin Rajonal Lezhe e ndare ne 19 lote” - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 2 vjeçar (24 muaj).

1. Mirëmbajtja parandaluese/preventive e pajisjeve mjekësore duhet të kryhet në përputhje me rekomandimet e prodhuesit përkatës për të parandaluar defektet që lidhen me përdorimin e tyre dhe pjesëve përbërëse, për të ruajtur pajisjet në gjendjen e duhur të funksionimit, për të siguruar cilësinë dhe besueshmërinë e rezultateve, për të evidentuar gjendje të tilla si vjetërsimi apo përkeqësimi i performancës.
2. Shërbimi për ndërhyrjet e mirëmbajtjes parandaluese, korrigjuese dhe kalibruese të pajisjeve mjekësore duhet të kryhet nga 2 (dy) Inxhinierë/Specialistë të certifikuar dhe të trajnuar për pajisjet mjekësore objekt prokurimi.
3. Operatori Ekonomik (Ofertuesi) duhet të paraqesë Rekomandimet nga prodhuesi i pajisjes/ve dhe një plan veprimesh të mirëmbajtjes parandaluese që përcakton periodicitetin, procedurat operative dhe protokollet që synon të përdorë, përfshirë kalibrimet.

Mirëmbajtja korrigjuese e pajisjeve mjekësore

1. Ndërhyrjet e mirëmbajtjes korrigjuese konsistojnë në përcaktimin e pranisë së një defekti ose mosfunksionimi, në identifikimin e shkaqeve, eliminimin e tyre dhe rivendosjen e karakteristikave origjinale, për garantimin e integritetit të pajisjes, të funksionimit dhe sigurisë së saj.
2. Shoqëria e kontraktuar (OE) duhet të kryejë shërbimin e mirëmbajtjes, riparimin dhe zëvendësimin e çdo defekti/pjesë të mundshëm/e gjatë periudhës së kontratës, për pajisjen dhe të gjithë aksesoreve të cilat janë të lidhura me të, në mënyrë që ajo të jetë në shërbim të stafit mjekësor si: Tuba X-ray, Dedektorë, Kompjutera, Hard Drive, DVD-CD, Keyboard, Monitor, RAM, UPS, Bllok ushqimi, printer, infrastrukture rrjeti, fisha, sonda, mansheta, sensorë, elektroda, Ingranazhe, pjesë elektronike, elektrike, mekanike, hidraulike, valvula, pjesë mekanike, rrota, pistona, motorrë etj, që ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin e pajisjes brenda standarteve të përcaktuara nga prodhuesi përkatës.
3. Shoqëria e kontraktuar (OE) duhet të paraqitet për të kontrolluar/verifikuar/konstatuar problematikën brenda 2 (dy) orëve nga marrja e njoftimeve (me e-mail dhe/ose telefon të të dhënat e kontaktit të paraqitur) nga Autoriteti Kontraktor për mosfunksionimin normal, probleme të ndryshme, konfigurime, sinjalizime apo defekte të pajisjes.
4. Në rastin kur nuk nevojiten pjesë këmbimi, korrigjimi i defektit duhet të realizohet jo më vonë se 48 orë pas konstatimit.
5. Në rast se konstatohet se për korrigjimin e një defekti nevojiten pjesë këmbimi, OE duhet të furnizojë dhe të vendosë pjesët e këmbimit, të riparojë defektin dhe të vendosë pajisjen në gjendje normale pune brenda 7 ditëve kalendarike.
6. Pas riparimeve apo ndërhyrjeve të kryera, zëvendësimi pjesësh këmbimi apo aksesorësh, shoqëria e kontraktuar (OE) duhet të kryejë kalibrimet e nevojshme, verifikimin e parametrave sikurse e rekomandon prodhuesi, për garantimin e funksionimit normal të pajisjes.
7. Shoqëria e kontraktuar do mundësojë të paktën një herë për secilën pajisje të grupit të pajisjeve lëvizjen, spostimin, çmontimin dhe rimontimin nëse kjo kërkohet nga Autoriteti Kontraktor.
8. Lëvizja, spostimi, çmontimi dhe rimontimi i pjesëve të pajisjes gjatë mirëmbajtjes korrigjuese është në ngarkim dhe përgjegjësi të të Kontraktuarit.

Furnizimi me pjesë këmbimi dhe aksesore

1. Materialet dhe pjesët e këmbimit duhet të jenë të reja, origjinale ose nga prodhues të tjerë të certifikuar, dhe gjithmonë në përputhje me ato të përdorura fillimisht në pajisje, duke siguruar konformitet me udhëzimet e dhëna nga prodhuesi në dokumentacionin teknik furnizuar me pajisjen.
2. Të jenë të certifikuara me CE sipas standardeve dhe direktivave të aprovuara në tregun European.

3. Kur është e aplikueshme, pjesët e këmbimit dhe aksesoret duhet të kenë manual instalimi shoqërues sipas rekomandimeve të prodhuesit. Një kopje e këtij manuali i dorëzohet përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor.
4. Pjesët duhet të kenë jo më pak se 1 (një)* vit garanci nga rikthimi në gjendje të plotë funksionale të pajisjes, ku të përfshihen të gjitha defektet e mundshme të tyre.

*(*Sqarim: Afati i garancisë së pjesëve të këmbimit mund të tejkalojë afatin e kontratës/marrëveshjes së lidhur. I kontraktuari detyrohet të mirëmbajë, sipas kushteve të garancisë, pjesën e këmbimit edhe pas afatit të përfundimit të kësaj kontrate nëse defekti i pjesës ndodh brenda afatit një vjeçar të garancisë së pjesës së këmbimit/ ose arritjen e maksimumit të konsumit të vërtetuar nga prodhuesi.)*

Inspektimi i sigorisë së pajisjeve mjekësore

1. Operatori Ekonomik duhet të kryejë të paktën 1(një) inspektim sigurie sipas standardit ndërkombëtar elektrik IEC 62353 të specifikuar nga Direktiva e Pajisjeve Mjekësore MDD (ose MDR) 98/79 EC (të përditësuar), ose EU 2016/425 (të përditësuar) ose FDA ose (EU) 2017/745 dhe azhornimet përkatëse, sipas aplikueshmërisë dhe Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Evropës, për çdo pajisje mjekësore dhe pjesëve përbërëse të saj gjatë periudhës së kësaj kontrate, nëpërmjet stafit të trajnuar dhe certifikuar, sipas nevojave të AK.
2. Operatori Ekonomik duhet të kryejë inspektim vizual, testime dhe matje me aparatura të kalibruara, në bashkëpunim me stafin e AK bazuar në specifikimet e prodhuesit.
3. Në përfundim të çdo inspektimi sigurie duhet të përpilohet një raport përshkrues dhe firmoset nga specialistët e AK dhe Inxhinieri/Specialisti i kompanisë (OE) që kryen testin.
4. Pas çdo testimi sigurie në pajisje duhet vendosur një shenjë treguese (të standardizuar nga AK) e gjendjes së sigorisë së pajisjes.
5. Përveç rasteve të sipërpërmendura, shërbimi i inspektimit e verifikimit të sigorisë duhet të kryhet edhe pas mirëmbajtjes korrigjuese, kur është e zbatueshme.
6. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kërkojë verifikime përveç atyre të planifikuara, në raste të veçanta, në kushte apo sipas nevojave të veçanta dhe Kontraktuesi është i detyruar të pranojë këto kërkesa pa kushte.

Detyrat: Mirëmbajtja e plotë e pajisjeve do të thotë se duhet të kryejë mirëmbajtjen parandaluese/preventive sikurse e cilëson prodhuesi, mirëmbajtjen korrigjuese të secilës pajisje dhe pjesëve përbërëse për çdo defekt të mundshëm pa përjashtuar pjesë specifike, inspektimin e sigorisë elektrike të pajisjeve mjekësore, furnizim dhe ndërrimin e pjesëve të këmbimit dhe aksesoreve si dhe transferimin dhe instalimin me kërkesë nga Autoriteti Kontraktues.

Shpërndarja: Në godinat e Maternitetit dhe Spitalit Rajonal Lezhe, në të gjitha shërbimet ku ndodhen pajisjet mjekësore të cilat janë përcaktuar në tabelat e detajuara dhe do të rifreskohen në momentin e lidhjes së kontratës me Operatorin Ekonomik fitues.

Shënim: Ndërprerja e Kontratës - Të parashikohet ndërprerja e kontratës për ato zëra kur përfundon supporti nga prodhuesi. Këto parashikime të jenë vetëm në rastet e paraqitjes së një dokumentacioni vërtetues nga prodhuesi. Afati i njoftimit të jetë jo më pak se 30 ditë.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Spitali Rajonal Lezhe

Argumentimi: Sasia dhe Grafiku i levrimit: janë vendosur në bazë të shkresës të Shkreses nr.918 prot., datë 06.08.2025 “Kërkesë” të Sektorit Teknik, si dhe shkresën nr. 979/2 Prot., datë 21.08.2025, “Proces-verbal mbi hartimin e kërkesave të vecanta për kualifikim” të specialistit të fushës, përlogaritjen fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt: **“Mirembajtje Full Risk e pajisjeve mjekësore për Spitalit Rajonal Lezhe e ndare në 19 lote” - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 2 vjeçar (24 muaj),** si dhe në përputhje me nenin 4, pika 36 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenin 41, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

NJËSIA E PROKURIMIT